



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 832/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK) dega në Gjilan, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së banerit në objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partise Demokratike te Kosoves (PDK) dega në Gjilan.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 12.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK-ja dega në Gjilan, në të cilën theksohet se me datën 03 nëntor 2013, në ora 06:45 PDK-ja dega në Gjilan, në hyrje të qendres së vendvotimit në shkollën fillore “Musa Zajmi” është vërejtur vendosja e posterëve të Hajriz Halimit kandidat për asamble komunale nga rradhet e subjektit politik të Lidhjes Demokratike të Kosoves dega në Gjilan. Me këtë rast kandidati në fjalë edhe vet LDK-ja kanë bërë shkelje ndaj rregullores Zgjedhore nr. 09/2013 për votimin, numrimin në vendvotim dhe menaxhimin e qendres së votimit të parapare me nenin 6, paragrafi 6.4 pika b, të po kësaj rregullore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se anëtari i subjektit politik të LDK-së Hajriz Halimi ka bërë vendosjen e posterit të vet në objektin e shkollës fillore “Musa Zajmi” në Gjilan, PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi nuk mund të vërtetohet se posterit i kandidatit të LDK-së është vendosur në objektin e shkollës ashtu siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së, si dhe nenit 3.6 pika c vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 832/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës Brenda njezetekater (24) oreve nga monenti i marrjes se vendimit nga PZAP